



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.05.2015, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. “Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.
2. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Eduard Halimi, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Arben Ristani, Vexhi Muçmataj, Blendi Klosi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Silva Caka, Pirro Lutaj, Armando Prenga, Mhill Fufi, Petrit Vasili.

Të ftuar:

Milena Harito – ministre e Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike

Eduart Shalsi - deputet

Genc Ruli - deputet

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përsëritje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, dhe si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.”

Së dyti, është projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar”.

Fillimisht do të dëgjojmë një paraqitje të iniciativave nga kolegët dhe më pas relatorët për të bërë vlerësimet e tyre. Gjithashtu, kemi edhe zonjën Ministre që mbulon fushën e veprimtarisë së saj “Për shërbimin civil”.

Zoti Shalsi, keni fjalën!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Të nderuar kolegë, ju falënderoj për mundësinë që na jepni për t’u prezantuar. A kam kohë në dispozicion, apo t’i përmbledh në mënyrë koncize?

Iniciativa është e përbashkët e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, që vjen mbas një analize të thellë të problematikës.

Është ngritur një problem i madh lidhur me stafin e ERE-s, modelimin e tyre, raportet me kompanitë që duhet të mbikëqyrin, rekrutimet si edhe me mënyrën se si mbahet një punë. Ka një disproporcion, që shkon në një me dy dhe një me tre lidhur me nivelin e pagave midis titullarëve të ERE-s dhe institucioneve apo ndërmarrjeve, që ata duhet të mbikëqyrin. Kjo është shtysa e gjithë kësaj iniciative.

Së dyti, Shqipëria është anëtare e Komitetit të Ilinois-it dhe aktualisht ka mbajtur presidencën e radhës. Bashkë me zotin Ruçi dhe me zotin Bitri, kemi qenë në Vjenë në raportin vjetor të analizës, ndërkohë që me zotin Ruli javën që kaloi ishim në të parin takim ndërparlamentarë midis parlamentarëve të Europës dhe ndërparlamentarëve të vendeve kontraktore të Komitetit të Energjisë.

Shqipëria ka marrë detyrimet që rrjedhin nga Paketa e Tretë e Energjisë. Ligji “Për energjinë” në vetvete është një përmbushje e atyre hapave në rrugëtimin drejt Unionit të Energjisë, drejt energjisë së BE-së, pra si anëtare dhe si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, ka marrë përsipër disa detyrime, ku një nga të cilat, është pavarësia e Entit Rregullator të Energjisë. Pavarësia përmban disa elemente, një nga të cilat është edhe

prosperiteti i stafit lidhur me mënyrën se si rekrutohen, mënyrën se si mbahen në punë dhe raportet me kompanitë e huaja.

Së treti, në ligjin “Për energjinë”, në nenin 11, pika 7, dua të theksoj, se ligji “Për energjinë” është fryt i një bashkëpunimi intensiv me Komitetin e Energjisë dhe për të gjithë ata që nuk janë familjarë do të them dy fjalë për Komitetin e Energjisë, pasi ky është institucion, aksionerët e të cilit janë BE-ja dhe palët kontraktuese. Synimi është që të integrohet tregu European duke zgjeruar drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor, por jo vetëm, sepse tashmë është edhe Ukraina edhe Turqia në negociatat për t’u bërë palë kontraktore, por ideja është që të ketë një sistem plotësisht të integruar me njëri-tjetrin.

Në nenin 11 pika 7 të ligjit “Për energjinë” ka një paragraf, që është i sapomiratur dhe i përafuar me Paketën e Tretë Rregullatore të Energjisë, ku thuhet: “Bordi parashikon strukturën organizative të ERE-s, numrin e punonjësve, tagrin, trajtimet financiare të kryetarit, anëtarëve të Bordit, personelit, personelit teknik. Në përcaktimin e masës së pagave në trajtimet financiare dhe ndërfinanciare të personelit teknik, Bordi merr parasysh kushtet e tregut në nivelin e pagave në shoqëritë që kontrollohen në sektorin dymujor”. Ndërkohë, e fundit është që kemi një precedentë, kemi lexuar me shumë vëmendje të gjitha diskutimet, argumentet e zhvilluara, por edhe ato të dhëna në lidhje me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Pra, besojmë se ka një ngjashmëri të theksuar në trajtim, ndërkohë që argumentet e dhëna qoftë nga Ministria e Financës, qoftë nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike janë ligje burokratike, të cilat nuk kanë mundur të shqyrtojnë në thellësi dhe me profesionalistët thellësinë e problemit.

E fundit që dua të them, është që kemi hartuar ligjin “Për energjinë”, i cili është një hap cilësor në sektorin e energjisë. Tashmë që kompanitë duhet të ndahen, sepse nuk dua të hyj shumë në detaje pasi një pjesë e juaja janë familjarizuar, roli i ERE-s merr një dimension të veçantë dhe ky disproporcionalitet midis trajtimit të punonjësve në ERE dhe me institucionet e tjera që ERE mbikëqyrë, bëhet pengesë për krijimin e një autoriteti të pavarur, profesional dhe me integritet.

Ne mund të zgjatemi edhe më tej pasi iniciativa është e përbashkët, qëndrimi dhe argumentet janë të përbashkëta, por këto janë arsyt që ky propozim vjen te ju, të cilin ne besojmë që duhet marrë në konsideratë.

Nuk e di, në qoftë se zoti Ruçi dhe zoti Bitri, mund të shtojnë diçka, por jemi të hapur për pyetje dhe për sqarime.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Shalsi!

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Mund të dëgjojmë relatorin, zotin Fino!

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Në fillim dua të përshëndes nismën e deputetëve, Kryetarin dhe nënkryetarët për një arsye të vetme: ne mendojmë se kemi të bëjmë me një ligj unanim të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, pra me kryetarin dhe sekretarët. Absolutisht është e drejta e tyre dhe e marr dyfish për bazë kërkesën e tyre dhe jo thjesht si deputet, por si koleg dhe si drejtues të këtij komisioni. Unë do flas për argumentet në favor të tyre, siç tha pak a shumë edhe kolegu ynë si kryetar i Komisionit, por do të jap edhe argumente të kundërta.

Pyetja që unë që në fillim dhe që vërtet më shqetëson është se kam qenë një nga ata deputetë për shkak edhe të kohës që kam në parlament dhe kam bërë gjithmonë problem kur vjen buxheti i shtetit, kur miratojmë numrin e punonjësve në Shqipëri, kur miratojmë strukturat dhe kur miratojmë pagat e tyre.

Unë e kam ngritur shumë herë dhe ka qenë objekt diskutimeve të mia, që ne jemi shumë dorëlëshuar ose dorështrënguar duke filluar nga miratimi i pagës së Presidentit që është shkalla më e lartë dhe pastaj për miratimin e pagave të Kryeministrit, deputetëve, ministrat, zëvendësministrat, pra për ata njerëz, për të cilët ne i kemi miratuar ashtu siç e kemi miratuar.

Kur vjen puna për institucionet Kushtetuese, institucionet e pavarura në punën e tyre të përditshme, por që vijnë raportojnë në parlament, japin llogari e të tjera dhe miratojnë herë pas here struktura e tyre, miratojnë edhe paratë e tyre, ne tregohemi shumë të dorëlëshuar.

Unë e kam propozimin prej kohësh dhe më ka dhënë të drejtë edhe Kryetari i Kuvendit më keni dhënë të drejtë edhe ju Kryetar i Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, ku më keni thënë: “Ta kalojmë këtë radhë ligjin “Për buxhetin” sepse shumë shpejt do të japë porosi që ne të bëjmë një *database* të saktë për të gjitha institucionet kushtetuese, edhe me ministrinë e linjës për të bërë edhe këtu në Shqipëri si të që të gjitha institucionet kushtetuese, të pavarura të vlerësohen për punën e tyre që bëjnë, jo të vlerësohen për shkak se nuk marrin fondin nga buxheti i shtetit, ne mund ta dimë vetë strukturën dhe të marrim rrogë sa të duam, absolutisht jo, por të vlerësohen për punën që bëjnë se pavarësisht se marrin fonde nga licencat që japin, kjo nuk do të thotë që unë nxjerr më shumë të ardhura dhe duhet ta mbaj rrogën 5 milionë. Më falni, për këto shifra që po them, por unë dua që parlamenti kur i kam dhënë të drejtën si do të veproj dhe si do të konsolidoj në praktikë, edhe ai të japë një kufi, një taban maksimal për ndarjen e fondit të pagave për punonjësit.

Ky është thelbi i asaj që ne kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord të gjithë, që duhet të bëhet një unifikim në këto struktura kushtetuese dhe është detyrë e domosdoshme sepse nuk mund të ketë dy standarde, duhet një standard duke filluar nga Presidenti dhe ne të tjerët që të tregohemi tolerant dhe të japim një fond page për t'u japim mundësinë atyre të vendosin vetë qoftë strukturën, qoftë edhe pagat. Edhe reformat që ne bëmë për pushtetin vendor kanë të drejtën për të bërë strukturën me ligjin e ri.

Kryetarit të bashkisë nuk i lihet të bëjë rrogën e një punonjësi apo këshilltari sa të dojë. Kryetari merr nga buxheti i shtetit të dhënat se sa duhet ta ketë rrogën një punonjës, pasi anëtarët e tyre mund të bëjnë namin, mund të krijojnë shumë të ardhura prej tyre dhe të kenë një rrogë tri herë më shumë nga deputeti, sepse tani do të kenë mundësi të drejtojnë një bashki ende edhe më të madhe, por ne u kemi vënë kufij dhe të analizojmë që kjo duhet të jetë ndarja, kështu do të bëhet miratimi i strukturës për kryetar bashkie, por fondi i pagave do të jetë i tillë, pasi nuk mund ta tejkaloj aq apo kaq përqind.

Kërkesa ime themelore nga kjo pikëpamje do të thotë që unë bashkohem me propozimin e tre kolegëve deputetë, por do të ishte mirë zoti kryetar, që ne të vijmë në një mbledhje bashkë me komisionin zotit Shalsi, me komisionin tonë, me ministrinë përkatëse që merret me këtë çështje, e cila ka administratën publike dhe t'i miratojmë në një seancë plenare dhe të mos merremi më me këtë çështje. Duhet t'u themi atyre se këto janë fondet tuaja për pagat dhe në qoftë se gjatë viteve do të ketë rritje të pagave, që do të ndikojnë edhe te ne apo te Presidenti, do t'ua lëmë të hapur me ligj që nëse paga e tyre rritet, atëherë mund të jetë në funksion me ngritjen në detyrë të ketë në parlament.

Unë si relator kam këtë propozim, i cili do të ishte zgjidhja më e mirë e mundshme, që ne do të bëjmë për të gjitha institucionet tona, me argumentet e punësimit që do të parashtrij tani dhe të themi: Në rregull! Bëjeni, por mos hapni precedentë për institucione të tjera, sepse mund të ndodhë asnjë nga kolegët deputetë nuk dëshmon i pari për një mijë e një arsye dhe propozimi mund të bjerë.

Edhe një institucion tjetër ka të drejtë të marrë një rrogë më shumë dhe ata kanë precedentin e AMF-së, precedentin e ERE-s, dhe unë kam të drejtë që t'i rris pagat apo strukturën dikujt tjetër, prandaj të mos merremi me argumentet politike që kanë deputetët siç është çështja e AMA-s, por unë mendoj që ne duhet të ulemi në tavolinë, të ngremë një grup pune nga dy komisionet dhe të trajtojmë me kujdes që ata të marrin atë që meritojnë për punën që bëjnë dhe absolutisht nuk kam kundërshtim, sepse nuk po u jap nga xhepi im. Por, nëse duam një trajtim të barabartë dhe në funksion të ligjit me të gjitha institucionet

kushtetuese, unë mendoj se, kjo është mëse e drejtë që ne duhet ta bëjmë, pasi jemi vonuar dhe këtë e kemi thënë edhe herë të tjera.

Tani të vijmë te argumentet e tyre,. Të gjithë këtë sugjerim të parë e thashë për të më mirëkuptuar kolegët e mi pasi në parim unë nuk jam kundër, por jam kundër që të mos miratohen vetëm për ERE-n, nuk jam kundër, por duhet që ne të ulemi dhe të shikojmë mundësinë zgjidhjes së problemit të të gjitha institucioneve.

Unë jam kundër për një gjë tjetër, që ne nuk mundemi dot në qoftë se ky institucioni trajtohet me statusin e ligjit “Për nëpunësit civil”, të arrijmë të marrim vendime dhe t’i kalojmë nga statusi i ligjit “Për nëpunësit civil” te Kodi i Punës, sepse më duket mbrapsht. Unë them që të gjithë të trajtohen me statusin e nëpunësit civil. Në qoftë se do ta bëjmë këtë gjë, atëherë na hapet oreksi për të bërë më shumë në mënyra të tjera dhe me ligje të tjera. Mund të them unë jam dakord, por pse ta bëjmë këtë gjë? Pse duhet të bëjmë një status për nëpunësit civilë kur është çështje e pushtetit vendor? Ata duhet të marrin iniciativën dhe ta bëjnë në parlament, pasi kryetari i bashkisë mund të vejë dhe të heqë kë të dojë nga puna, me Kodin e Punës dhe nuk ka pse të përdorë nëpunësit civilë.

Tani kjo nuk ka logjikë, prandaj i thashë të gjitha këto që në fillim për të mos e kaluar sot, dhe ky është propozimi im dhe nuk është kryesori këtu. Të mos e kalojmë sot këtë propozim që thanë në parim tre kolegët tanë, ta marrim të mirëqenë se është një propozim i vlefshëm në funksion me të gjitha institucionet tjera kushtetuese, me të cilat duhet të bëjmë një *database* dhe ta sjellim këtu bashkë me komisionin e zotit Shalsi, i cili të na ndihmojë që ne të bëjmë një material përfundimtar dhe ta paraqesim në Kuvend për t’u miratuar nga të gjitha institucionet.

Më lejoni të them tani arsyet pse jam në favor të këtyre iniciativave. Arsyeja e parë është ndalesa e stabilitetit që janë rreth 3-fish më të ulëta nga pozicionet respektive në kompanitë që operojnë në tregun e energjisë dhe kjo është një gjë negative, pasi nuk kanë pse të jenë tre herë më të ulëta pagat e stabilitetit në raport me këtë gjë.

E dyta, burimet e financimit të ERE-s përbëhen nga pagat e rregullimit që paguajnë të licencuarit në sektorin e energjisë, pra nuk marrin gjë nga buxheti i shtetit. Këto të ardhura i kanë nga të ardhurat e veta, por edhe drejtësia mund të ketë të ardhurat e veta, por drejtësisë do t’i themi: Jo, kaq e ke fondin pagave duke filluar nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë e kështu me radhë. Ata i nxjerrin të ardhurat nga gjyqësori, por nuk mund t’u themi që nga ato të ardhura që ju nxirrni mund të rrisni pagat tuaja. Unë këtë e quaj faktor pozitiv në favor të rëndësinë e pavarësisë së rregullatorëve dhe ky është objekt trajtimi edhe në Paketën e Tretë Rregullator për Energjinë, e cila insiston në pavarësinë thelbësore siç e tha edhe

kryetari të rezolutshmërisë së sekretariatit komplet të energjisë, në raportit vjetor të zbatimit të vitit 2014.

Nga ana tjetër ligji nr. 43, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë” të cilën e cilësoi fort kryetari i komisionit dhe më duhet ta cilësoj edhe unë fort, që ne e kemi kaluar dhe ajo që më bën të përdor edhe pak humor, zoti kryetar, është që sa shpejt e kaluam ligjin “Për energjinë” dhe sa shpejt mbas një jave, kur me siguri shumë nga deputetët nuk e kanë lexuar nenin këta erdhën dhe e cilësuan duke thënë: “Meqenëse ne e miratuam ligjin e ri “Për energjinë” para një jave, ligji na detyron ne tani me shtabin urgjent (kur akoma nuk është thashë boja e dekretimit) të miratojmë një ligj ku në nenin 11, pika 7 përcaktohet se: “Bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s, numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimin financiarë të kryetarit, të anëtarëve të Bordit si edhe të personelit teknik”.

Zoti Kryetar, ky nen, të cilit akoma nuk i është tharë boja e miratimit nga ngritja e dorës sonë në këtë përkufizim, këta u ngritën me vrap dhe ata që nuk e prishën ligjin “Për energjinë” vetëm për këtë nen që u miratua, pas një jave vijnë dhe thonë: “Ne duam të rrisim pagën tonë”. Kjo është arsye punësimi dhe nuk kam si ta hedh poshtë, sepse vetë e kemi gërricur dorën, nuk e kisha lexuar këtë nen sepse nuk do ta votoja dhe do të isha më i qetë tani si relator se nuk do t’ju thosha: Ku i keni të bazuar në ligj?

Më lejoni kolegë, t’ju jap disa argumente negative, argumente në kundërshtim me tuajat.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Së pari, objekti kryesor në lidhje me fushëveprimin Kodit Ligjor të Shërbimit Civil, është krijimi i një regjimi homogjen për të gjitha ato pozicione, të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e autoritetit publik dhënë nga ligji publik dhe që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të shtetit, kjo është kryesorja gjë të cilin ju nuk e keni pasur në konsideratë.

E dyta, lidhur me argumentin e dhënë se rregullat e punësimit janë një komponent i rëndësishëm i pavarësisë së një rregullatori, sqarohet se rregullimi i marrëdhënieve të punës të nëpunësve të ERE-s me legjislacionin e Shërbimit Civil, nuk përbën cenim të pavarësisë së institucionit dhe as nuk krijon probleme për cilësinë e stafit të tyre. Vetë ky legjislacion synon tërheqjen në administratën publike të individëve të aftë dhe profesionalistë, si edhe përforcimin e mbrojtjes së tyre në lidhje me marrëdhëniet e punës. Konkretisht me ligjin 152/2013 përcaktohet se: “Administrimi i Shërbimit Civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit

dhe paanësisë politike si edhe garanton qëndrueshmërinë e nëpunësve civilë”. Në vazhdimësi të Shërbimit Civil, ky është një nen shumë i rëndësishëm që duhet të merret në konsideratë.

Së treti, ligji numër 9584 datë 17.07.2006 i ndryshuar ka si qëllim rekrutimin e kompetencave për miratimin e strukturës dhe organikës e institucioneve të pavarura si edhe kompetencave për miratimin e pagave të këtyre institucioneve, ndërkohë që në lidhje me pagat e titullarëve, të institucioneve të pavarura, të përcaktuara në këtë ligj në raport me pagën e Presidentit synohet edhe krijimi i hierarkisë së pagave. Rregulli i përcaktuar në këtë ligj është i njëjtë për të gjitha institucionet dhe nuk merret në konsideratë si kriter mënyra e financimit të institucioneve për të përfshirë atë në fushën e veprimit ose jo. Një argument tjetër, i katërt, lidhur me nivelin e pagave të nëpunësve të ERE-s, Këshilli i Ministrave sqaron se ERE mund të dërgojë pranë Ministrisë të Shtetit për Inovacionin, Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave propozimet e saj për pagat, gjë të cilën unë mesa di unë e ka dërguar dhe është dhënë përgjigje negative.

E fundit, lidhur me pavarësinë e institucionit miratimi i strukturës dhe i organikës së ERE-s nga Kuvendi nuk e cenon atë, se në fund të fundit është krijuar me vendimin tonë dhe nuk i hyjmë në cenim, përkundrazi ne e kemi krijuar dhe ajo e raporton te ju si komision, gjithashtu kolegët të vijnë dhe ta raportojnë se nuk ka cenim të institucionit.

Në çdo rast ERE është një institucion, që raporton në lidhje me veprimtarinë e saj në Kuvendin e Shqipërisë dhe si e tillë do të thotë se ka një varësi raportimi dhe nëse ka këtë varësi raportimi siç janë edhe institucionet tjera raportuese si gjykatat e të tjera me radhë, natyrisht i takon këtij parlamenti të miratojë edhe strukturën ose mund ta miratojë vetë komisioni. Kjo është një çështje, të cilën e zgjidh seanca, por mund ta kaloni edhe vetëm ju si komision, që institucionet kushtetuese sipas varësisë që kanë, kush është në komision të ligjeve, kush është në komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, kush është në Komision të Ekonomisë mund të trajtohen në komisione se ne kemi besim te njëri-tjetri dhe të miratojmë strukturën dhe pagat e tyre, pa kaluar në seancë plenare.

Rregulli e ka pasur që deri tani këto çështje kanë ardhur dhe janë trajtuar në seancë plenare. Unë mendoj që propozimi i kolegëve tanë të ruhet i depozituar dhe të bashkohet me të gjitha institucionet e tjera kushtetuese që ne kemi dhe të vijë si një paketë për të kaluar në seancë plenare, por duke rregulluar edhe rastin në fjalë. Natyrisht pastaj do të hyjmë që të shikojmë edhe anën teknike. Unë po ju them vetëm një gjë, në qoftë se sipas hierarkisë mbi rrogën e Presidentit të Republikës nuk duhet të dalë asnjëri. Paga e Presidentit të Republikës është paga më e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe pas atij vjen ajo e Kryeministrit e kështu me radhë. Kjo do të thotë që të gjitha institucionet që janë këtu në Shqipëri duke

filluar që nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, kam dëgjuar kushedi sa e sa gjëra në 8 vjetët e kaluara, për mua personalisht, por edhe si ekonomist duhet të jenë paga poshtë nivelit të pagës së Presidentit të Republikës. Atëherë, zotërinj, ejani dhe ta bëjmë rrogën e Presidentit të Republikës 10 milionë lekë, kushdo qoftë presidenti apo 5 milionë dhe pastaj këto ente të kenë mundësi që të marrin një pagë më shumë, por në qoftë se Presidenti merr 2 milionë lekë rrogë nuk mund të marrë Bashkim Fino, që është guvernator 5 milionë lekë rrogë në muaj. Ky ka qenë gjithmonë qëllimi im dhe për këtë gjë, zoti Kryetar, unë kërkoj mirëkuptimin e kolegëve të mi, të cilët na kanë sjellë këto materiale, por duhet të kemi një mirëkuptim edhe me institucione të tjera kushtetuese për ta kaluar në seancë plenare në funksion të buxhetit të shtetit dhe të pagës më të madhe në Shqipëri, që është paga e Presidentit të Republikës.

Faleminderit, për vëmendjen!

Fatmir Xhafaj –Faleminderit, zoti Fino! Zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Unë dua të shtoj diçka nga ajo që tha Bashkimi, duke qenë se jam bashkërelatore dhe dua të ndalem te pjesa e mendimit për ligjin “Për nëpunësit civil”.

Në fakt relacioni nuk e nxjerr të qartë pse kërkohet që stafi i ERE-s të përjashtohet nga statusi i nëpunësit civil. Në relacion ju thoni që për pavarësinë e institucionit kanë rëndësi burimet financiare dhe njerëzore, kjo është e vërtetë, por nuk arrij të kuptoj se si ligji “Për nëpunësin civil” mund të cenojë pavarësinë e një institucioni, sepse nuk është e qartë nga kushdo pavarësi ky institucion.

E para, unë do të doja të sillja në vëmendjen tuaj që ligji “Për nëpunësin civil” i miratuar me konsensus në Kuvendin e Shqipërisë, u ndryshua në dhjetor dhe ne patëm mundësinë dhe kemi pasur një debat shumë të hapur pasi e mbajtëm disa kohë në dorë për t’i dhënë mundësinë për të bërë të gjitha rregullimet. Pse e sollëm ligjin në dhjetor dhe nuk e ndryshuam më parë kur ne konstatuam probleme madje edhe kushtetuese në ligj? Sepse menduam, sikurse e kërkoi në ligj edhe Departamenti i Administratës Publike, ky ligj filloi të zbutohej, të shikonim se çfarë problemesh do të nxirrte në praktikë, që të shikonim të gjitha problematikat që lidheshin me zbatimin e tij në nivele të caktuara. Ne gjetëm disa probleme që kryesisht biem dakord, transferimet, problemet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, probleme të lidhjes së varësisë së DAP-it nga Ministria e Brendshme, që normalisht nuk ishte e tillë apo probleme që lidheshin me ASP-në, pra me shkollën shqiptare të administratës publike. Ndërkohë, meqenëse kemi diskutuar dhe thamë që me statusin e nëpunësit civil nuk mund të jenë ato ofrojnë shërbime, hoqën ato institucione që ofronin shërbime. Ky problem nuk u ngrit në atë kohë kur ne diskutuam ndryshimet në ligjin

“Për nëpunësin civil”. Nga ana tjetër, po t’i referohemi ligjit të nëpunësit civil aty thuhet qartë që këtij ligji i nënshtrohen çdo nëpunës që ushtron funksion publik, në një institucion të administratës, institucione të pavarura apo njësi vendore dhe ERE është institucion i pavarur

Unë kam një pyetje. Sa ente publike kemi ne në Shqipëri? Çfarë u ndodh këtyre enteve nëse ne miratojmë këtë ndryshim? A u lind e drejta enteve të tjera publike të kërkojnë përjashtimin nga statusi nëpunësit civil të stafit të vet? Nëse ne heqim nga statusi i nëpunësit civil stafet, ato do të jenë më të pavarura apo do të jenë të varura?

Nëse i referohemi mënyrës se si përzgjidhen stafit. Në relacion thuhet që: “Legjislacioni për shërbimin civil i pengon ata të ofrojnë pagesa konkurruese dhe nuk sjell profesionalizëm”. Nëse dikush shpall një vend vakant, qoftë edhe ERE është ai së bashku me DAP-in që përcakton kriteret, që duhet të përmbushin personat që i nënshtrohen këtij konkurrimi.

Padyshim DAP-i ka kriteret e një nëpunësi civil, por askënd nuk pengon që kriteret që duhen vënë për vendet vakant t’i përgjigjen atij niveli profesionalisti.

Nëse vijmë te paga, kolegu Fino, e shpjegoi shumë mirë. Ai ka ngritur këtë problem dhe unë e mbështes fort, do të vazhdojmë të bëjmë këto cenime vazhdimisht në ligjin “Për nëpunësin civil”? Pse të mos e mendojmë ligjin që ka të bëjë me sistemin e pagave, ligjin e 2006-ës dhe për ta rregulluar në tërësi. Nga ana tjetër do të doja kolegë deputetë t’u sjell në vëmendjen tuaj, që nuk është DAP-i ai që i zgjedh punonjësit e ERE-s, por duke qenë një institucion i pavarur Drejtoria e Burimeve Njerëzore tek ERE i bënë vetë konkurset, pra i ka vetë në dorë nëse do të marrë njerëz profesionistë apo do të marrë njerëz më pak profesionistë, do të marr ekspertë apo do të bëjë përzgjedhje jo profesionale.

Në këtë kuadër ndërhyrja në këtë ligj, zoti kryetar, duhet të jetë e kujdesshme dhe nëse do ta bëjmë për ERE-n, atëherë duhet ta bëjmë për të gjitha entet publike në Shqipëri. Unë personalisht është e treta herë që jam relatore për ligjin “Për nëpunësin civil” dhe nuk ndihem mirë që hera-herës e cenojmë këtë ligj dhe krijohet përshtypje sikur duam të bëjmë qoka për të rregulluar një institucion, për të rregulluar një drejtor që të marrë stafin e vetë e të tjetra.

Unë e vlerësoj që të tre kolegët kanë ardhur bashkë dhe është model që tre kolegë të tre forcave politike janë bashkë, por në sytë e publikut mendoj që, tingëllon jo mirë sepse mund të ngrihen edhe entet e tjera dhe të kërkojnë një gjë të tillë, prandaj si lëndë unë them ta sugjerojmë. Bashkohem me atë që tha edhe kolegu, që nismën ta lëmë siç është, ta shikojmë në tërësi dhe do të doja shumë edhe mendimin e ministres Harito. A pëlqehet kjo gjë që ne të

heqim entet stafet e enteve nga statusi i nëpunësit civil, sepse po e bëre për këtë do ta bësh për të gjitha pastaj?

Meqenëse ky ligj është konsultuar gjerësisht me SIGMA-n, me Bashkimin European, janë në dijeni ata të këtij ndryshimi që po bëjmë se tek AVP-ja ata kishin dhënë opinionet e tyre. Unë në cilësinë e relatores kam pasur opinionin e tyre në dorë.

Unë këtë kisha për të thënë dhe mendoj se edhe kolegët propozues mund të na japin përgjigje edhe për pyetjet që unë shtrova.

Si cenohet pavarësia nëse dhe drejtoritë e burimeve njerëzore të këtyre enteve i zgjedhin të bëjnë konkursin? Çfarë do të ndodhë nëse do të kërkojnë edhe entet e tjera, duke shtuar stafin?

E treta, pse themi që një konkurs, që organizohet nga vetë enti, që është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, cenon pavarësinë e stafit?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Ruli, urdhëroni!

Genc Ruli – Do të doja një përkthim të prezantimit, që bëri zoti Shalsi për këtë nismë. Do të përkufizoja më saktë se sa është perceptuar qëndrimi ynë.

(incizim i dobët)

Në qoftë se në ligj do të jetë me status privat patjetër që mund t'ua japim.. Sot për sot nuk ka as vetë treg rregullatore, pra, kur shteti merr përsipër me gjithë kostot e deformimit, që krijon kjo, që të na rregullojë tregun... Kjo drejtori jep një licencë që mund ta ketë xhiron vjetore 1 miliard euro. Do të thoni ju edhe një ministër ka në dorë gjëra të rëndësishme, sidoqoftë kemi ekzekutivin me gjithë funksionimin e tij me kontrollin nga parlamenti, me kontrollin nga hallka të tjera, është më i monitoruar se ç'janë entet rregullatore në veprimtarinë e tyre. Prandaj janë të parat midis të barabartëve me aktorë privat dhe prandaj ju bëjmë referencë ne me pagat e sektorit privat. Pra nuk e kemi shpikur ne, por na e kërkojnë si standard, siç e kanë bërë të tjerët, ta aplikojmë edhe ne.

Bashkim Fino - Mirë është që unë dhe ti, dhe e meritojmë, se jemi si senatorë ne të dy, të marrim pagën e deputetit european, gjerman, italian...

Ne marrim pagë tjetër si deputetë, sepse këto kushte janë në Shqipëri, ndërsa ai duhet të marrë atë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Genc Ruli – Unë nuk thashë të marrin pagë europiane, por të marrin pagë si biznes.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se nuk keni ndonjë gjë se duhet të flasë edhe komisioni...
(Diskutim pa mikrofon.)

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – A janë institucionet në.... Mua më rezulton që shkronjat e nenit 2, që përjashtohen nga “a” deri te “gj”, janë ose institucione, ose kategori institucionesh. Këtu po flitet që të shtohet edhe shkronja “ll”, pra janë shkronjat “h”, “i”, “j”, “k” dhe “l”. Kështu që pyetja është: Cili mbetet dhe çfarë i mbetet shërbimit civil? Sigurisht një qasje e integruar është gjëja më e mirë dhe unë besoj se ligji e kishte dhe është pikërisht ndërhyrja që u bë fillimisht. U postua ligji totalisht derisa filloi të zbatohet dhe ka sjellë... I bie të jetë neni i gjashtë ose pika e gjashtë pas miratimit ...

A e kanë marrë statusin e nëpunësit civil këta punonjës të administratës së ERE-s sot dhe nëse miratohet ky ligj çfarë pasojash do të ketë mbi këta persona?

Nuk po hyj fare te pjesa tjetër, te ndryshimet.

Pyetja e fundit është retorike, ne kemi një nen të miratuar në një ligj tjetër, i cili përcakton se si rregullon si i përcakton pagat pavarësisht nëse ka hyrë ose jo në fuqi.

Ligji civil është me shumicë ushtruar dhe nuk mund të ndiej presion mbi... duhet të rregullojmë një fushë shumë sensitivë që na e kërkon edhe BE-ja. Të ndryshojmë për shkak se kemi bërë një ndryshim kjo nuk është inkompatibiliteti i dispozitave. Unë nuk e kam me propozuesit, se i kuptoj shumë mirë për atë që propozojnë. Ne ndoshta biem dakord një moment dhe e thyejmë konceptin që kemi një hierarki pagash. Ndoshta unë nuk jam i kënaqur, apo kushdo tjetër në administratën publike, i duhet se s’bën të matet me Presidentin e Republikës, sepse mund të dalë në sektor privat dhe merr shumë më tepër. Këtu thuhet se personat demotivohen dhe na ikin te kompanitë. Atëherë, mund të kthehet në klauzolë, nëse pranon të hysh, le të themi me një pagë të mirë, pas një iks kohe që largohesh nuk mund të shkosh në asnjë kompani, e cila rregullohet...

Pra, mund të ketë shumë të drejtë. Unë në parim jam... Pa një qasje të integruar që po na çon në një situatë, ku ligji pritet si fetat e sallamit, nuk e di çfarë do të mbetet në fund.

E dyta, me një qasje që secili vjen, sepse ka një interes për ta bërë, ndoshta edhe të drejtë, ne do të kemi një shërbim civil, që do të shpartallohet kjo formë dhe nuk është se kemi zgjidhur ndonjë gjë. Ose do të ndërrojmë konceptin e hierarkisë së pagave dhe të shkojmë diku tjetër, ose do ta respektojmë atë dhe të mbetemi...

Fatmir Xhafaj – Zoti Shalsi, pastaj zonja Ministre!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti kryetar!

Të gjitha këto shqetësime kanë qenë pjesë e debatit tonë. Çështja nëse zgjidhja duhet dhënë *en block* në të gjitha entet publike të pavarura rregullatore, ka qenë edhe shqetësimi ynë. Ne mendojmë se ka ardhur koha që të jepet një zgjidhje *block*. Do të kishim pritur, do të kishim kontribuar në rast se do të kishim kohë. Emergjencia e miratimit të ligjit, por mbi të gjitha e reformave të nevojshme në sistemin energjetik na bëri të inicionim dhe ta shtynim më shpejt nga sa do ta donim edhe ne. Pra kjo është arsyeja. E ritheksoj, bashkë me shqyrtimin e ligjit që zoti Fino ka qëndruar për një kohë shumë të gjatë në komisionet parlamentare, ka qenë paralelisht me kërkesën tonë.

Së dyti, zoti Fino tha rastin e Presidentit. Ndërkohë, rasti i Presidentit i AMF-së është, dhe pasi lexuam edhe raportin e SIGMA-s, edhe argumentet e parashtruara në komision dhe çfarë kishin thënë kolegët e nderuar të këtij komisioni, jo rastësisht në fillim të argumenteve të mia nuk vendosa thjesht dhe vetëm përputhjen me detyrimet dhe përgjegjësitë që kemi marrë me qenien anëtarë të komunitetit të energjisë, por vendosa evidentimin e problemit të madh që kemi me cilësinë e stafit me mbajtjen në punë me rekrutimin e njerëzve, sepse në vëmendjen tonë, e nderuara kolege Hysi, ishte rekomandim i SIGMA-s, i fondit të Bankës Botërore. Në rastin konkret, ne nuk jemi thjesht dhe vetëm të bëjmë me një sugjerim rekomandim të fortë të komunitetit të energjisë, ku ne jemi anëtarë, por kemi bindjen tonë që duke i dhënë këtë mundësi entit i krijojmë, i japim një mjet që sigurisht është i pamjaftueshëm, por është i domosdoshëm për të përmirësuar cilësinë e punës së entit.

Pra, duke lexuar argumentet i dëgjova me shumë vëmendje edhe argumentet e zonjës Hysi, janë po të njëjtat shqetësime, që duhet të kishin qenë edheAutoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Ndërkohë, mjaftonte që SIGMA të rekomandonte, apo Banka Botërore dhe fondi apo ishte edhe bindja juaj? Në konkluzionet tona vullneti juaj për ta votuar ka të bëjë me bindjen tuaj përpara se të jepni përmbushje një rekomandimi pavarësisht se nga vjen.

E pra, ne kemi edhe bindjen, edhe detyrimin për ta nxjerrë entin nga ai pozicion ngërçi ku ndodhet dhe për t'i dhënë mundësitë të operojë në një situatë krejtësisht të re energjetike.

Për ta mbyllur, aktualisht punonjësit e ERE-s nuk e kanë statusin e nëpunësit civil...

(Diskutime pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Do ta sqaroj edhe ministria. As punonjësit, as komisionerët nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, aktualisht. Ju lutem, çfarë do të ndodhë në rast se kanë

statusin? Shumë e drejtë, por më tej do ta sqaroj edhe ministrja. Ndaj nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar.

Këto ishin argumentet dhe shqetësimet. E vlerësoj, ndaj edhe një pjesë të shqetësimit bashkërisht, zgjidhja u bë për entet rregullatore, por emergjenca e sektorit të energjisë na kërkon që të marrim një masë të tillë që besojmë se është masë e drejtë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Shalsi!

Zonja Ministre, së pari duam të dimë se cili është qëndrimi i qeverisë për këtë, si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të kolegëve.

Milena Harito – Për të qartësuar debatin, kolegët propozojnë diçka që për mua ngatërron dy çështje:

Ligji i shërbimit civil rregullon pavarësinë nga politika. Struktura e pagave përpiket të rregullojë pavarësinë nga sektori privat dhe nga tentativat e korrupsionit. Pra, po flasim për dy gjëra të ndryshme. Ligji i shërbimit civil nuk rregullon çështjen e pavarësisë nga tentacioni që kanë personat në të gjitha postet që nga entet rregullatore deputetët, ministrat, Kryeministri, Presidenti dhe kushdo qoftë.

Këtë e rregullon struktura e pagave pjesërisht. Sigurisht në asnjë vend nuk e rregullon vetëm struktura e pagave e rregullojnë edhe shumë gjëra të tjera. Po flas për pjesën e parë, që është shërbimi civil, që rregullon vetëm pavarësinë nga politika. Nëpunësit e ERE-s sot janë në shërbim civil dhe këtu po përpiqem t'i jap përgjigje kolegut.

Oerd Bylykbashi – U është dhënë statusi apo e kanë pritshmëri të ligjshme?

Milena Harito – Kanë statusin e nëpunësit civil. Për t'i dhënë përgjigje shqetësimit tuaj për ligjin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Sigurisht ka tentativa dhe qartësisht kjo është e lidhur me punësimin me arbitraritetin e punësimit nga cilido qoftë. Të gjitha tentativat për të nxjerrë njerëz nga shërbimi civil janë të lidhura me arbitraritetin e punësimit. Ju e dini shumë mirë ligjin e shërbimit civil. Ai është një nga ligjet që na u vu kusht për të marrë statusin kandidat. Amendimet e tij u negociuan 6 deri në 10 muaj me BE-në shumë të strukturuar dhe shumë të pjekur. Vetëm në komision kemi kaluar mbi 72 orë duke diskutuar çdo presje. Qëndrimi i qeverisë është i qartë. Nuk mund të ndryshohet ligji i shërbimit civil çdo herë që dëgjohet një interes i caktuar i një grupi të caktuar që do të çrregullojë sërish varësinë e punonjësve nga politika. Pra, nëpunësit janë profesionistë të përzgjedhur sipas kritereve, por janë të pavarur edhe nga politika. Kjo nuk i bën aspak të pavarur nga sektori privat. Kjo është e vërtetë për

ERE-n, është e vërtetë për Telekom, që është 6% e GDP-së së Shqipërisë, është i vërtetë për AMA-n

(Diskutime pa mikrofon.)

Po e sqaroj edhe një herë. Entet rregullatore rregullojnë sektorin e energjisë dhe sektorët e tjerë të ekonomisë së Shqipërisë. Një tjetër sektor i ekonomisë së Shqipërisë, që prodhon 6% të GDP-së është sektori i Telekomunikacionit dhe ka një ent rregullator. E njëjta çështje që ushtron për entin e energjisë mund vështrohet fare mirë për entin e Telekomunikacionit. E njëjta gjë mund të shtrohet për AMA-n. Megjithëse vlerat monetare nuk janë të mëdha influencat e pushtetit janë jashtëzakonisht të mëdha, ndoshta edhe më të mëdha se vlerat monetare.

Pra çështja në kuptimin e ligjit të shërbimit civil nuk ka këtu asnjë relevantë, në lidhje me çështjen që shtrohet, që këta njerëz duhet të jenë paguar më mirë. Pra, për mua kjo pikë nuk ka lidhje. Ata rekrutohen dhe ka një strukturë pagash hajde të diskutojmë pikën numër 2, që është pika e strukturës së pagave.

Kalojmë te pika e dytë, struktura e pagave. Ka dy aspekte: një i cili ka dhënë nëpërmjet Ministrisë së Financave për koherencën e buxhetit të shtetit dhe këtu pavarësisht se kolegët ngrenë faktin se ata mbledhin të ardhura nga sektori i energjisë këto janë sidoqoftë fonde publike që nga momenti i një enti publik.

Pra, ti u nënshtrohesh rregullave publike dhe këto rregulla mund t'i diskutojmë dhe kemi çështjen e strukturës së pagave, të hierarkisë së strukturës së pagave dhe këtu i vetmi argument që unë mund të them është se nuk më duket që anëtarët e bordit të ERE-s janë më pak të influencueshëm, siç janë deputetët dhe ministrat.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Dakord. Nuk ka rëndësi. Mund të mos e kenë marrë letrën, por e kanë fituar të drejtën e tyre që nga momenti që ligji ka dalë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ajo tashmë është një e drejtë e fituar.

Milena Harito – Kanë qenë 3 mijë vetë në administratën qendrore....

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - ...dhe në qoftë se është aplikuar në datën 1 tetor, ata 10 mijë veta...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zonja Ministre me gjithë respektin është një debat që nuk ka shumë lidhje me këtë, pra e shfokuson atë.

Do të vijë në raport administrata publike.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Shalsi, do t'i jepni përgjigje zotit Manja?

Eduard Shalsi – Bordi rregullator i komitetit të energjisë mbledhur në takime dhe të mbikëqyrura ka konstatuar se ky problem nuk është vetëm shqiptar është edhe rajonal dhe ka ndikuar në vendimmarrjen e enteve dhe në uljen e autoritetit të tyre, në raportin e fundit.

Ky fenomen ndodh vetëm në pak vende të rajonit dhe detyrimi që Kroacia e ka marrë vendimin, Mali i Zi po e merr vendimin, Serbia, Maqedonia dhe Kosova janë angazhuar shumë shpejt që ta zgjidhin këtë çështje. Pra, ky është një problem rajonal që po zgjidhet, dhe pastaj këtu vlen edhe për ministren e nderuar, që anëtare e komitetit të energjisë është Shqipëria. Në rast se do të dorëzojmë paketën e energjisë ka detyrimin dhe përgjegjësinë dhe kjo ka të bëjë edhe me shqetësimin e zonjës Hysi, me plotësimin e detyrimeve ndërkombëtare.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët?

Oerd Bylykbashi – Për sa i përket nëpunësit civil ia thashë përgjegjësitë...

Fatmir Xhafaj – Po, do të vijë ministria javën tjetër do të jetë në raport.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Mbajta shënim faktin që këto 6 ndryshimet ose 5 janë bërë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Nga shkronja “gj” ka arritur te shkronja “l”. Tentativa të dala me sukses.

Vasilika Hysi – Nuk është tentativë është e konsumuar.

(Diskutime pa mikrofon.)

E dyta që theksoj është se janë persona të cilët në mos kanë marrë

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë jam kundër idesë së piramidës së pagave. Nuk po them gjë për këtë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse ne kemi një ligj i cili do të cenonte në mënyrë, një e drejtë e fituar, një pritshmëri të ligjshme të fituar e bëjmë vulnerabël përpara Gjykatës Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Me sa shikoj, nuk ka gjë tjetër. Unë dëshiroj të them dy-tri gjëra.

E para, bashkohem edhe me vlerësimin e kolegëve e të Komisionit të Ligjeve që nisma e tre kolegëve të nderuar dhe shumë të respektuar, është një nismë shumë pozitive në qëllimin e saj.

Më duhet të them se e kam lexuar me vëmendje edhe relacionin, dëgjova edhe çfarë u parashtrua këtu dhe në vlerësimin tim argumentet që e mbrojnë idenë propozimin e tyre janë për t'u respektuar dhe meritojnë një vëmendje të veçantë kur analizon problemin në interesin publik dhe shoqëror që ka.

Me thënë të drejtën unë nuk jam shumë i bindur dhe nuk bëj pjesë tek ata që do ta pranoja një lidhje midis çështjes së pagës dhe pavarësisë së institucioneve, se sa do të duhej të isha në favor të një lidhjeje midis pagës dhe eficiencës së institucionit. Këtu do ta mbështesja fort idenë e propozuesve.

Gjithashtu, u trajtua edhe çështja që ka të bëjë me raportin midis AMF-së, ERE-s etj. Unë dëshiroj të bëj me dije se ne nuk kemi qenë shumë dakord me atë ndryshim që kemi bërë edhe tek AMF-ja dhe kemi përdorur të njëjtën logjikë, por (dhe e them këtë, nuk kam pse hezitoj), ka qenë më shumë një vendimmarrje politike-institucionale e maxhorancës, sesa një vendimmarrje e komisionit në sensin e bindjes së brendshme që duhej marrë sa kohë që AMF-ja ishte një ent rregullator, siç është ERE, AKEP-i, ERU-ja dhe u argumentua me një kusht të vendosur nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, e cila kishte vullnetin, mbështetjen e plotë të qeverisë që insistonte në nevojën për ta miratuar këtë gjë. Ne në komision kemi mbajtur gjithmonë një qëndrim parimor dhe ka ardhur momenti që të ketë një zgjidhje të unifikuar, një zgjidhje të njësuar për të gjitha këto institucione, dhe kjo është arsyeja që mbi bazën e një shqetësimi të ngritur në komision dhe më pas në seancën plenare, ne kemi ngarkuar institucionin e Shërbimit të Monitorimit, i cili ka bërë një analizë paraprake, por që, fatkeqësisht, ajo analizë ka mbetur vetëm te niveli i strukturave dhe nuk ka shkuar te një lidhje më e mirë, për të bërë një analizë më të plotë ndërmjet strukturës, pagës dhe eficiencës së institucioneve në raport me përgjegjësitë e mëdha që kanë funksionet respektive. Kjo është e vërteta, më duhet ta pranoj dhe që duhet plotësuar, por druaj se, duke marrë një vendim të tillë, ndoshta do të kemi një shpërpjesëtim të raporteve ndërmjet institucioneve të ngjashme që ka tregu, që do të thotë se kemi dhënë një zgjidhje me AMF-në dhe kanë shumë të drejtë kolegët tanë dhe ERE-ja ta pretendojë këtë gjë, sepse nuk besoj se AMF-ja rregullon një pjesë të tregut që ka më shumë përgjegjësi seç ka ajo që mbulon ERE si agjenci. Gjithashtu do të thosha që nuk ka ndonjë përgjegjësi jo të vogël AKEP-i apo pavarësisht se sot nga pikëpamja e rëndësisë apo vlerësimit që ne i bëjmë duket si një vlerë jo e veçantë ERU-t, por shumë shpejt jam bindur se do ta kuptojmë që kemi bërë të njëjtin gabim siç kemi bërë me energjinë, ndërsa kemi dashur të bëjmë diçka shumë më mirë në gjithë këta vjet një pas një me energjinë, por nuk kemi bërë të njëjtën gjë me ujin dhe do të

ktthehemi përsëri tek ERU-ja, pra është momenti për të bërë një zgjidhje të plotë në këtë aspekt.

Së dyti, mendoj edhe një qasje tjetër për të mos prishur ekuilibrat dhe këtë jemi duke e parë te rasti i gjyqësorit, ku këtu po flasim për disa ente që nuk janë një pushtet i pavarur, ndërkohë që ne kemi në diskutim çështjet e strukturave të pagave në reformën në drejtësi lidhur me gjyqësorin, me një pushtet tërësisht të pavarur, një nga tri degët e rëndësishme të pushtetit dhe ne jemi në një diskutim dhe dilemë shumë të madhe lidhur me raportin që ka paga dhe qëndrueshmëria, përgjegjshmëria dhe eficaenca e tyre në detyrë.

Jemi duke gjetur një zgjidhje, që, në qoftë se do të ulemi dhe do ta shohim si qasje, ndoshta mund të jetë e aplikueshme edhe këtu, që ata të mbeten brenda hierarkisë së pagave dhe bonuset për efekt të funksionit, të detyrës apo të gradave në rastin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve që është një ide e hedhur, për shkak se ekspertët nuk kanë arritur në një zgjidhje definitive, duke qenë se ka disa alternativa mund të jetë një qasje nuk e shpërpjeston sistemin dhe u jep një vlerësim tjetër për efekt të përgjegjësisë, funksioneve që mbulojnë disa institucione, siç janë ato të lidhura me pushtetin gjyqësor, entet rregullore apo institucione dhe agjenci që kanë një rol të veçantë në sistemin financiar dhe ekonomik të vendit.

Aspekti i dytë lidhet me shërbimin civil. Nuk e di sa e prish kjo gjë, me thënë të drejtën, nuk e di se sa ka 10, 15 punonjës ERE, ERU apo AKEP-i, ku të gjithë ekuilibrat e sistemit dhe qëllimi që ka pasur ligji i shërbimit civil, pasi unë, më falni zonja Ministre, personalisht mendoj që qëllimi i ligjit nuk ka qenë thjesht dhe vetëm të ruajë disa institucione të kësaj natyre, por ka pasur parasysh një kuadër më të plotë, ka pasur parasysh qëndrueshmërinë e administratës, duke i nxjerr institucionet e kësaj natyre dhe duke i lidhur këto me pavarësinë institucionale që këto kanë me ligj. Kjo nuk e cenon thelbin e ligjit “Për shërbimin civil”.

Gjithsesi, unë mendoj që t’i lëmë pak kohë vetes, të diskutojmë edhe një herë me qeverinë dhe ministrinë përgjegjëse, por dhe vetë qeveria të marrë një vendim për të bërë një studim dhe nëse është e nevojshme në një kohë shumë të shpejtë, duke marrë shkak edhe nga propozimi i kolegëve të mund t’i japim një zgjidhje tërësore këtij problemi, për të pasur një qëndrim të përcaktuar qartë, do të kemi dy qëndrime një me AMF-në dhe një ERE-n? Do të kemi dy qëndrime një me ERE-n dhe një me AKEP-in? Nëse do të kemi një qëndrim, cili do të jetë ky qëndrim? Nëse do të kemi një qëndrim, ky qëndrim do të mbështetet nga ata që ne na financojnë, na asistojnë dhe na monitorojnë apo do të duhet të na thonë përsëri një hap para, dy hapa mbrapa dhe ne me gjithë personalitetin që kërkojmë të vendosim apo iniciativat e mira detyrohemi të korrigjojmë vetveten. Kështu që nga ky aspekt le t’i kërkojmë edhe

qeverisë që të japë një opinion duke qenë se ka edhe ekspertët e nevojshëm, dhe njëkohësisht drejtoria që ne kemi së bashku me stafet e të dy komisioneve, edhe ato nga ana tjetër të jenë pjesë e kësaj analize dhe në një kohë të shpejtë të marrim një vendimmarrje që unë mendoj se do të jetë më e plotë.

Eduard Shalsi – Flasim për aspektin procedural vetëm, propozimi është konkret. Komisioni, ashtu sikundër Komisioni i Ekonomisë, pas këtyre gjërave do t'i duhet të shprehet. Ne si Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, meqenëse kemi qenë më në kontakt dhe më në brendësi të ligjit të energjisë, duke ju kujtuar përgjegjësinë e madhe që kemi, do të donim që një moment në rast se pas opinionëve të komisioneve respektive, të kërkonim të shprehte vullnetin sovran, pra parlamenti.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë që ta kuptojmë tek ana procedurale, unë thashë se kishit ndonjë gjë tjetër për anën procedurale, por e kishit gabim. Kjo pa dyshim që do të vejë, sepse ka një rregull, këtu po hyri, do të dalë në parlament, që do të thotë që ka hyrë në parlament dhe dalja është në seancë, se ne marrim një vendim ta rrëzojmë, se ne marrim një vendim ta ndryshojmë, se ne marrim një vendim që të japim një opinion, siç e keni sjell ju, në çdo njërën nga këto zgjidhje do t'i drejtohem seancës. Mos u nxitoni për këtë, prisni, të shikojmë si do të vejë gjërat, pasi në seancë do të vijë dhe unë e kuptoj shumë mirë qëllim tuaj që, edhe po nuk deshëm ne, është seanca që e vendos, patjetër. Ne jemi aq të përgjegjshëm dhe të mençur sa ta kuptojmë këtë gjë.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Të gjithë bëjnë presion dhe na thonë që kalojeni ju si komision se ne do të vijmë seancë. Unë jam totalisht kundër, pasi jam edhe relator....

Fatmir Xhafaj – Edhe para, edhe pas ndërhyrjes suaj edhe ne e dimë që jemi pjesë e sovranit.

Bashkimi Fino – Kolegët tanë kanë ardhur dhe janë të ftuar këtu, siç jemi edhe ne të ftuar në komisionin e tyre. Më fal, kam marrë fjalën dhe jam anëtar i komisionit me të drejta dhe kohë të plotë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju, zotëri, nuk jeni me kohë të plotë në këtë komision, je i respektuar atje ku je dhe të rrish atje ku je, këtu je i ftuar, fole disa herë, tani e kam fjalën unë.

(Diskutime pa mikrofon)

E di rregulloren unë, jam i vjetër. Tani që e kam marrë fjalën unë, më dëgjo mua. Mos fol sikur je kryetar komisioni edhe këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk kam gjë personale me ty unë...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam me kohë të plotë këtu. Ti vazhdon të mos kuptosh, në qoftë se nuk kupton, ik siç iku edhe Genci me Bertin.

Unë jam me kohë të plotë këtu dhe kam të drejtë të diskutoj, madje fatkeqësia jote e di kush është, se ti je kryetar komisioni dhe e di shumë që e hap dhe e mbyll mbledhjen ti në komisionin tënd.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, po, e ke në Rregullore. Edhe në komisionin tonë e hapi zotëria, bëri konkluzionet, e mbylli. Ti ndërhyre padrejtësisht për herë të fundit dhe na detyron që të rihapim diskutimin dhe të marrim një vendim. Unë dua të ngre dorën. Jam kundër këtij propozimi! Nuk kam gjë me ty personalisht, e kam me kryetarin tim që u tregua oportunist. Shënojeni atje që unë jam kundër këtij propozimi. Le të bëjnë lobingun që të marrin votat në parlament, t'i marrin. Unë jam kundër.

Fatmir Xhafaj – E mbyllim këtu mbledhjen.

MBLEDHJA MBYLLET